


SISTEMI PARALEL SHËNDETËSOR NË KOMUNAT ME SHUMICË SERBE

DHJETOR 2020



Ky hulumtim është realizuar në kuadër të projektit "Promovimi i një procesi të mirinformuar dhe pjesëmarrës në fazën finale të dialogut Kosovë-Serbi" i mbështetur nga Ambasada e Zvicrës dhe Ambasada Gjermane në Kosovë.

Autorë: Bekë Veliu dhe Fitim Gashi

COPYRIGHT © 2020. Kosova Democratic Institute (KDI)

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat e rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Tel: +383 (0)38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Ueb: www.kdi-kosova.org

Qëndrimet e paraqitura në këtë punim janë të autorëve dhe nuk paraqesin qëndrimet e Institutit Demokratik të Kosovës, Ambasadës Zvicerane dhe Ambasadës Gjermane në Kosovë.

SISTEMI PARALEL SHËNDETËSOR NË KOMUNAT ME SHUMICË SERBE

DHJETOR 2020

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	6
2. SISTEMI I KUJDESIT SHËNDETËSOR NË KOSOVË.....	7
2.1. Organizimi i kujdesit shëndetësor publik.....	7
2.2. Financimi.....	7
3. SISTEMI SHËNDETËSOR NË KOMUNAT ME SHUMICË SERBE.....	9
3.1. Institucionet e kujdesit shëndetësor.....	9
3.2 Financimi i institucioneve të kujdesit shëndetësor në komunat me shumicë serbe.....	10
4. SHËNDETËSIA NË KONTEKST TË DIALOGUT KOSOVË-SERBI.....	12
4.1. Historiku i dialogut Kosovë-Serbi.....	12
4.2. Bisedimet lidhur me sektorin e shëndetësisë.....	13
5. PËRFUNDIME	15
6. REKOMANDIME.....	16
BIBLIOGRAFIA.....	17



Ky hulumtim synon që të ofrojë një pasqyrë të sistemit paralel shëndetësor në komunat me shumicë serbe. **Hulumtimi shqyrton dokumentet dhe literaturën ekzistuese mbi sistemin paralel shëndetësor në komunat me shumicë serbe. Funksionimi i këtij sistemi shqyrtohet në kontekst të dialogut Kosovë-Serbi.**



1. HYRJE

Ligji për shëndetësi, i cili rregullon sistemin shëndetësor në vend, në masë të madhe mbetet i pazbatuar në dhjetë komunat me shumicë serbe. Kjo si pasojë e mosintegritimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor në këto komuna në sistemin unik shëndetësor të Kosovës. Edhe pse buxhet i veçantë ndahet nga buxhet i konsoliduar i Republikës së Kosovës për shërbimet shëndetësore në këto komuna, pjesa më e madhe e këtij buxheti mbetet i pashfrytëzuar. Në anën tjetër, miliona euro ndahen çdo vit nga Republika e Serbisë, gjë e cila mundëson funksionimin e këtyre institucioneve jashtë sistemit shëndetësor të Republikës së Kosovës.

Mospërfshirja e institucioneve shëndetësore të komunave me shumicë serbe në sistemin shëndetësor të Kosovës ka bërë që këto institucione të mos raportojnë qoftë për numrin e punonjësve apo shërbimet që ofrojnë. Kësisoj, mungon një pasqyrë e saktë e profilit shëndetësor dhe saktësi e të dhënave në Kosovë, për shkak të kufizimit në shtrirje.

Ky hulumtim synon që të ofrojë një pasqyrë të sistemit paralel shëndetësor në komunat me shumicë serbe. Hulumtimi shqyrton dokumentet dhe literaturën ekzistuese mbi sistemin paralel shëndetësor në komunat me shumicë serbe. Funksionimi i këtij sistemi shqyrtohet në kontekst të dialogut Kosovë-Serbi.





2. SISTEMI I KUJDESIT SHËNDETËSOR NË KOSOVË

2.1. Organizimi i kujdesit shëndetësor publik

Sistemi shëndetësor në Kosovë rregullohet përmes Ligjit për Shëndetësi dhe është i organizuar në tri nivele: nivelin parësor, dytësor dhe tretësor (Ligji për shëndetësi, 2013)¹. Niveli parësor përfshin qendrat e mjekësisë familjare, të cilat ofrojnë shërbime të përgjithshme të diagnostifikimit dhe trajtimit mjekësor. Administrimi dhe menaxhimi i institucioneve shëndetësore të nivelit parësor bëhet nga komunat. Secila komunë ka nga një Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), ndërsa rrjeti i institucioneve shtrihet tutje përmes Qendrave të Mjekësisë Familjare (QMF), gjithsej 151 sosh. Në nivelin dytësor të institucioneve të shërbimeve shëndetësore hyjnë spitalet rajonale dhe qendrat e tjera për shërbime specialistike, të cilat menaxhohen nga niveli qendror. Në nivelin tretësor të sistmit shëndetësor bën pjesë Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Qendra klinike universitare stomatologjike, Instituti kombëtar i shëndetësisë publike, Qendra kombëtare e mjekësisë së punës, Qendra kombëtare e mjekësisë Sportive, dhe Qendra kombëtare e transfuzionit të gjakut. Ky nivel menaxhohet nga niveli qendror. Në të trija nivelet Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për mbikëqyrjen e këtyre institucioneve. Krahas shërbimeve publike të kujdesit shëndetësor,

ekzistojnë edhe mbi një mijë institucione private, të cilat ofrojnë shërbime të ndryshme mjekësore, 28 prej tyre edhe shërbime spitalore, krahas atyre ambulatore.²

Përjashtim në këtë rregullim të përgjithshëm institucional bëjnë tri komunat me shumicë serbe: Mitrovica Veriore, Graçanica, dhe Shtërpca. Këto tri komuna, krahas kompetencave për nivelin parësor, menaxhojnë edhe ofrimin e kujdesit dytësor shëndetësor. Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, "kompetencat e zgjeruara të këtyre komunave përfshijnë të drejtën për regjistrimin dhe licencimin e institucioneve të përkujdesit shëndetësor, punësimin e personelit mjekësor, pagesën e rrogave dhe trajnimin e personelit dhe administratorëve të përkujdesit shëndetësor".³

2.2. Financimi


Sistemi publik shëndetësor në Kosovë financohet drejtpërdrejt nga buxheti i shtetit. Rreth 8% e buxhetit të përgjithshëm të shtetit ndahet për Ministrinë e Shëndetësisë. Kjo i bie rreth 3% e Bruto Produktit Vendor (BPV), shifër kjo më e vogla në rajon.⁴ Krahas buxhetit që ndahet për nivelin qendror, buxheti i veçantë për shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor ndahet edhe për komunat e vendit, përfshirë edhe komunat me

1 Ligji për shëndetësi i miratuar më 2013. Gjetur në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8666>

2 Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021. (2016). Ministria e Shëndetësisë. Gjetur në http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia-sektoriale-e-shendetesise-final-nentor-2016-ALB_.pdf

3 Ligji për vetëqeverisjen lokale i miratuar më 2008. Gjetur në <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

4 Stanculescu, M. S., & Neculau, G. (2014). The Performance of Public Health-care Systems in South-East Europe. Friedrich Ebert Stiftung. Qasur më 23.03.2021



shumicë serbe. Ndërkaq për tri komunat me kompetenca të zgjeruara buxhet i veçantë ndahet edhe për kujdesin sekondar shëndetësor. Në buxhetin e vitit 2021, për komunën e Gracanicës janë ndarë 1,140,771 euro për kujdesin dytësor.⁵ Për Mitrovicën e Veriut ky buxhet ishte 989,935 euro, ndërsa për komunën e Shtërpcës 522,371.

Përkundër që në parim qasja në shërbimet shëndetësore është pa pagesë, buxheti që ndahet për shëndetësinë mbulon vetëm 60% të shpenzimeve të kujdesit shëndetësor; pjesa tjetër - 40% - janë shpenzime private (out-of-pocket expense) të pacientëve për mbulimin e kostos së shërbimeve apo produkteve mjekësore.⁶

Në vitin 2016 Ministria e Shëndetësisë ka hartuar Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë 2017-2021. Riorganizmi i financimit shëndetësor është një nga objektivat kryesore gjatë kësaj periudhe, ku përfshihet edhe funksionalizimi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Në vitin 2014, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për sigurimin shëndetësor,⁷ i cili parasheh një model të ri të financimit të sistemit shëndetësor, përmes sigurimit shëndetësor të obligueshëm. Mirëpo ky model i financimit nuk është arritur të funksionalizohet ende. Sektorët e arsimit dhe shëndetësisë në veri nuk përfshihen në buxhetin e nivelit lokal që administrohet nga komunat në përputhje me ligjin e Kosovës për administratën lokale. Lënia jashtë pagesave e këtij sektori, ka ndikuar që realizimi i buxhetit të komunave të jetë i ulët. Komuna e Mitrovicës së veriut për vitin 2018 për paga dhe shtesa kishte buxhet në vlerë prej 3 milionë e 265 mijë e 409 eurosh. Prej tyre janë shpenzuar vetëm 2 milionë apo 61 për qind. Sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit, ky nivel i ulët i realizimit të buxhetit ishte për shkak të mospagesës së pagave për punëtorët në sektorin e arsimit dhe atij të shëndetësisë, si rezultat i rrethanave politike në komunat veriore⁸

⁵ Ligji për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, miratuar nga Kuvendi i Kosovës

⁶ Kosovo Report (2020), European Commission.

⁷ Ligji për Sigurimin Shëndetësor, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 2014.

⁸ <https://www.koha.net/arberi/184606/shthurja-e-shendetesise-nuk-u-sherua-nga-dialogu-i-brukselit/>

Përkundër që në parim qasja në shërbimet shëndetësore është pa pagesë, buxheti që ndahet për shëndetësinë mbulon vetëm

60%
TË SHPENZIMEVE TË
KUJDESIT SHËNDETËSOR



PJESA TJETËR

40%
JANË SHPENZIME PRIVATE
(OUT-OF-POCKET EXPENSE) TË
PACIENTËVE PËR MBULIMIN E
KOSTOS SË SHËRBIMEVE APO
PRODUKTEVE MJEKËSORE

3. SISTEMI SHËNDETËSOR NË KOMUNAT ME SHUMICË SERBE

3.1. Institucionet e kujdesit shëndetësor

Institucionet shëndetësore në mjediset e populluara me shumicë serbe në Kosovë vazhdojnë të funksionojnë në kuadër të sistemit të Serbisë. Kjo ka bërë që këto institucione të mos raportojnë në institucionet e Republikës së Kosovës qoftë për numrin e punonjësve apo shërbimet që ofrojnë. Një gjë e tillë konfirmohet edhe nga dokumentet e Ministrisë së Shëndetësisë. (Shëndetësisë, 2016)⁹. Kësisoj, mungon një pasqyre tre të saktë e profilit shëndetësor dhe saktësi e të dhënave në Kosovë, për shkak të kufizimit në shtrirje.

Për nevoja të këtij hulumtimi, autorët e punimit kanë pyetur Ministrinë e Shëndetësisë të Kosovës për numrin e institucioneve të kujdesit shëndetësor në komunat me shumicë serbe, mirëpo e njëjta nuk ka ofruar të dhëna. I vetmi dokument që ofron të dhëna mbi institucionet shëndetësore në këto komuna është Profili i Komunave, i hartuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë. (Municipal Profiles, 2018)¹⁰.

Sipas këtij dokumenti, numri më i madh i objekteve shëndetësore gjendet në katër komunat veriore, aty ku është i përqendruar më së shumti komuniteti serb. Në Mitrovicën e Veriut është spitali kryesor i cili ofron shërbime falas për të gjithë serbët që jetojnë në Kosovë.

Ata janë të pajisur edhe me kartela shëndetësore ku autoritetet lëshues është Qeveria e Serbisë. Derisa Kosova ende nuk aplikon sigurim shëndetësor, në veri ekziston edhe Zyra e Fondit Republikan për Sigurime Shëndetësore të Republikës së Serbisë, me degë të saj në Zubin Potok, Prilluzhë, Leposaviq dhe Zveçan.

Në Komunën e Mitrovicës së Veriut ekziston edhe poliklinika që ofron shërbime shëndetësore për studentët e kësaj pjese. Në "Kodrën e Minatorëve", ku jetojnë serbë dhe shqiptarë, shërbimet ofrohen nga një qendër shëndetësore.

Në komunën e Zveçanit ndodhet një shtëpi e shëndetit dhe 4 ambulanta për ofrimin e kujdesit parësor shëndetësor. Në këtë komunë janë të punësuar rreth 155 punonjës shëndetësorë, përfshirë mjekë, infermierë dhe staf tjetër përcjellës.

Në komunën e Zubin Potokut është një shtëpi e shëndetit dhe 6 ambulanta për ofrimin e kujdesit parësor shëndetësor. Në këtë komunë janë të punësuar gjithësej 77 punonjës shëndetësor. Po ashtu, në fshatin Cabër të populluar me shqiptarë, është edhe një shtëpi e shëndetit e cila funksionon brenda sistemit shëndetësor të Kosovës.

Në komunën e Leposavitit është një shtëpi e shëndetit dhe 8 ambulanta, prej të cilave vetëm dy janë funksionale. Në këtë komunë janë gjithësej 135 punonjës shëndetësor.

⁹ Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021. (2016). Ministria e Shëndetësisë. Gjetur në http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia-sektoriale-e-shendetesise-final-mentor-2016-ALB_.pdf

¹⁰ Municipal Profiles. (2018). OSCE Mission in Kosovo. Gjetur në <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/municipal-profiles>.



Ndërkaq një qendër mjekësore është në fshatin Bistricë e Shalës, i populluar me shqiptarë, dhe funksionon brenda sistemit shëndetësor të Kosovës.

Në komunën e Shtërpçës është një qendër e mjekësisë familjare dhe 7 shtëpia të shëndetit të fshatrat e populluara me shqiptarë dhe serbë. Kjo komunë ka gjithsej 22 punonjës shëndetësorë.

Në komunën e Kllokotit janë dy qendra mjekësore, të cilat menaxhohen nga serbët. Janë gjithsej 15 punonjës shëndetësor.

Në Partesh, sistemi i kujdesit shëndetësor përfshin një maternitet të drejtuar nga Serbia, si dhe tri objekte të kujdesit shëndetësor në fshatrat Pasjan, Budrigë e Poshtme dhe Partesh.

Në Ranillug janë 8 qendra mjekësore, të gjitha të financuara nga buxheti i Komunës. Në këtë komunë janë gjithsej 28 punonjës shëndetësorë.

Në Novobërdë është Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) e cila funksionon brenda sistemit shëndetësor të Kosovës. Ndërkaq janë edhe 9 qendra të tjera mjekësore, 8 prej të cilave funksionojnë me sistem të Serbisë. Janë gjithsej 36 punonjës shëndetësorë në këtë komunë.

Së fundmi, në Komunën e Graçanicës ndodhet Qendra Klinike Spitalore si dhe dy institucione spitalore, ai i pediatriisë dhe internistikës. Në fshatrat e kësaj komune janë poashtu edhe 15 ambulanta. Pas përfundimit të luftës në vitin 1999, Graçanica u shndërrua në qendrën kryesore shëndetësore për serbët, pasi kjo qendër por edhe institucionet tjera u zhvendosën nga Prishtina. Por

spitali i Graçanicës, që po ashtu funksionon nën ombrellën e sistemit shëndetësor të Serbisë nuk ka objekt të vetin dhe veprimtarinë e ushtron në disa kontejnerë të metaltë. Në vitin 2018, Qeveria e Serbisë premtoi të ndajë mjete për ndërtimin e spitalit, por deri më tani është përcaktuar vetëm lokacioni ku do të ndërtohet ky objekt. (Cvetkoviq, 2020)¹¹

3.2 Financimi i institucioneve të kujdesit shëndetësor në komunat me shumicë serbe

Beogradi ka ndikuar që këto institucione të mos integrohen në sistemin e Kosovës. Pengesat që vijnë nga Serbia lidhen me pagesat apo stimulimin financiar që ua bënë këtyre institucioneve shëndetësore. Zyrtarë të Serbisë kanë paralajmëruar tranzicion të sistemit shëndetësor, por vetëm në kuadër të projekteve të përbashkëta me Ministrinë e Shëndetësisë së Serbisë. (New Perspektiva, 2017)¹² Ata e kanë bërë të qartë në vazhdimësi se, transformimi nuk nënkupton edhe integrimin e shëndetësisë serbe brenda ligjeve të Kosovës.

Mbështetur në të dhënat e portalit kolikokostakosovo.info, i cili ka mbledhur të dhëna mbi shpenzimet e shtetit serb për Kosovë, rreth 300 mijë euro ndahen mesatarisht çdo vit për sistemin shëndetësor në komunat me shumicë serbe. (Koliko Kosta Kosovo, n.d.)¹³ Gjysma e këtyre mjeteve financiare janë për pagat e punonjësve shëndetësorë në këto komuna.

Mungesa e kontrollit të Prishtinës zyrtare mbi komunat e populluara me shumicë serbe u konfirmua edhe gjatë pandemisë COVID-19. Vendimet e kryetarëve të komunave veriore dhe shtabeve që i krijuan koordinoheshin me qeverinë

¹¹ Spitali i Graçanicës qe dy dekada në kontejnerë. (2020). Evropa e Lirë: <https://www.evropaelire.org/a/spitali-i-gracanices-ne-kontejnere-/30988585.html>. Qasur më 23.03.2021

¹² Shëndetësia paralele në veri të Kosovës. New Perspektiva. (29.09.2017). Gjetur në <https://www.new-perspektiva.com/sq/shendetesia-paralele-ne-veri-te-kosoves/>. Qasur më 23.03.2021

¹³ Koliko Kosta Kosovo. Gjetur në <http://kolikokostakosovo.info/en/>. Qasur më 23.03.2021





e Beogradit, e jo atë të Prishtinës¹⁴ (Office for Kosovo and Metohija, Government of the Republic of Kosovo, 2020).

Ndërhyrjet e Serbisë vazhduan edhe gjatë pandemisë COVID-19 duke tentuar t'i furnizojë institucionet në komunat veriore me vaksina. Më 21 janar 2021, Inspeksioni që vepron në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë të Kosovës, shoqëruar nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës, e bastisi Qendrën Shëndetësore në Shtërpçë, e cila funksionin me sistemin shëndetësor të Serbisë. Kontrolla u bë në Departamentin e Vaksinimit, ambulancën COVID-19 si dhe Departamentin e Kirurgjisë të kësaj komune. Megjithatë inspektorët nuk gjetën vaksina, Prokuroria Themelore e Mitrovicës autorizoi policinë që të mbledh informacione në lidhje me veprimet e mundshme kriminale të kontrabandës së barnave dhe aktiviteteve të paligjshme mjekësore. (Prokurori i Shtetit, 2021)¹⁵

Po ashtu në veri, Beogradi e shtriu edhe vaksinimin e qytetarëve serb. Institucionet e Kosovës nuk kanë pasur asnjë komunikim zyrtar me institucionet e Serbisë lidhur me këtë çështje, as të drejtpërdrejtë përmes Zyrave Ndërlidhëse të të dyja vendeve e as me ndërmjetësimin e bashkësisë ndërkombëtare .

Ndërkaq polemika të mëdha kishte shkaktuar futja e 1000 testeve nga Serbia, me lejen e qeverisë së Kosovës pas shpërthimit të pandemisë COVID- 19. Lejimi i këtyre pajisjeve por edhe mjekëve të cilët ndihmuan veriorët në menaxhimin

e pandemisë, u bë me kërkesë të ndërkombëtarëve. Në prill të vitit të kaluar, ministrat e shëndetësisë të të dyja vendeve përmes një video-konference të organizuar nga Ambasadori i Italisë në Prishtinë, Nicola Orlando, u zotuan për bashkëpunim të ndërsjellë në menaxhimin e pandemisë¹⁶

Furnizimi i qendrave shëndetësore me medikamente dhe materiale tjera përcjellëse vazhdon të bëhet nga Serbia. Por në disa raste Dogana e Kosovës ka ndaluar futjen e paautorizuar të medikamenteve dhe kartelave të sistemit shëndetësor të Serbisë në territorin e Kosovës. (Dogana e Kosovës, 2016)¹⁷ Para tri viteve Dogana kishte kthyer mbrapsht 918 kartela shëndetësore, të dedikuara për banorët serbë në Kosovë.



Zyrtarë të Serbisë kanë paralajmëruar tranzicion të sistemit shëndetësor, por vetëm në kuadër të projekteve të përbashkëta me Ministrinë e Shëndetësisë së Serbisë.

¹⁴ Uebfaqja e Qeverisë së Republikës së Serbisë. (18.05.2020). Gjetur në <http://www.kim.gov.rs/lat/v3829.php>. Qasur më 23.03.2021

¹⁵ "Pas informacioneve të pranura dhe raporteve në media lidhur me futjen potenciale të vaksinave anti-COVID në pjesën veriore të Kosovës pa përfilur dispozitat e zbatueshme ligjore, Prokuroria Themelore në Mitrovicë, në bashkëpunim të ngushtë me policinë, janë duke mbledhur informacione për të vlerësuar nëse vaksinat janë sjellë në Kosovë, si dhe nëse importimi i tyre është bërë në pajtim me protokollet përkatëse për mbrojtjen e shëndetit publik dhe kërkesat ligjore që rregullojnë këto çështje". Komunikatë për media nga Prokurori i Shtetit: <https://prokuroria-rks.org/psh/lajm/6314>. Qasur më 23.03.2021

¹⁶ Ambasadori Orlando, në një postim në "Facebook" tha se "çmon angazhimin e tyre për të kapërcyer distancat dhe për t'u përqendruar në shëndetin e të gjithë qytetarëve si përparësi kryesore", 15/04/2020.

¹⁷ Dogana parandalon kontrabandën e barnave në rajonin e Gjilanit. (17.11.2016). Dogana e Kosovës. Gjetur në: <https://dogana.rks-gov.net/dogana-parandalon-kontrabanden-e-barnave-ne-rajonin-e-gjilanit/>. Qasur më 23.03.2021





4. SHËNDETËSIA NË KONTEKST TË DIALOGUT KOSOVË-SERBI

4.1. Historiku i dialogut Kosovë-Serbi

Që prej shpalljes së pavarësisë dialogu me Serbinë në Bruksel e ka dominuar agjendën shtetërore të Kosovës. Përveç ndikimit që ka pasur në procesin e integritit evropian, dialogu ka prekur edhe organizimin e brendshëm të shtetit. Negociatat kishin marrë hov pas rezolutës së vitit 2011 të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, e cila kishte mandatuar qeverinë dhe kryeministrin ta udhëheqë këtë proces. (Rezolutë për dialogun midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, 2011)¹⁸ Por me kushtin që në asnjë rast të mos preket sovraniteti i Kosovës, subjektiviteti, integriteti territorial, si dhe rregullimi i brendshëm dhe kushtetues.

Por çështjet e diskutuara prej dialogut teknik që më vonë u shndërrua në politik kanë qenë për rregullimin e brendshëm. Në emër të shuarjes së strukturave paralele të Serbisë dhe integritit të komunitetit serb brenda juridiksionit të Kosovës, janë miratuar ligje të reja e janë ndryshuar ato ekzistueset. Përgjatë këtyre viteve kanë ndodhur zhvillime nisur nga organizimi për herë të parë i zgjedhjeve edhe në komunat e populluara me shumicë serbe, e deri tek dualizmi i legalizuar në qeverisjet lokale. Ndërkaq, më 19 prill të vitit 2013 procesi kulmoi me nënshkrimin e të ashtuquajturës Marrëveshja e

Parë për Normalizimin e Marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. (Marreveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve, 2013)¹⁹ Por afatet e vëna për zbatimin e marrëveshjeve që pasuan atë të 2013-ës janë shkelur disa herë dhe shumë prej dokumenteve nuk kanë gjetur zbatim as pas 10 vitesh dialog.²⁰ (KDI, 2018)

Jo transparencja dhe mungesa e llogaridhënies e kanë shoqëruar procesin. “Dyktimësia konstruktive”- element ky i aplikuar në negociatat e lehtësuara nga Brukseli ka krijuar terren palëve që t’i interpretojnë versionet e tyre të marrëveshjeve duke fajësuar palën tjetër për mos implementimin e atyre për të cilat janë dakorduar. Për pasojë, shumë prej dokumenteve të dialogut teknik e politik vazhdojnë të mos gjejnë zbatim edhe pse janë negociuar e rinegociuar disa herë.²¹ Bashkimi Evropian në rolin e lehtësuesit, vetëm ka njoftuar për takimet e mbajtura, përmes komunikatave për media, por nuk i ka interpretuar marrëveshjet. Po ashtu mungesa e një mekanizmi mbikëqyrës dhe autoriteti interpretues të marrëveshjeve, e ka bërë të vështirë matjen e nivelit të zbatueshmërisë së tyre.

Faqet zyrtare të qeverisë së Kosovës dhe Serbisë kanë qenë platformat e vetme ku janë publikuar disa prej marrëveshjeve dhe raportimeve periodike. Kanë munguar raportimet e rregullta në Kuvendin e Kosovës përveç në rastet e interpe-

18 Rezolutë për dialogun midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 2011.

19 Marreveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve. (2013, 04 19). Gjetur në https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Marreveshja_e_Pare_per_Normalizimin_e_Marredhenieve_19_prill_2013.pdf. Qasur më 23.03.2021.

20 Dialogu Kosovë-Serbi: Sfidat dhe rruga përpara. (2018). Instituti Demokratik i Kosovës (KDI).

21 Ibid.





lancave, pyetjeve parlamentare apo raportimeve në Komisionet. Raporti i fundit që flet për gjendjen e zbatimit të marrëveshjeve të Brukselit është publikuar në korrik të vitit 2017. (Zyra e Kryeministrit, 2017)²²

Ndërprerja e ndërhyrjeve të Serbisë në Kosovë në fushat tjera që nuk janë trajtuar në Marrëveshjet e Brukselit, ku bënë pjesë edhe shëndetësia ishte menduar të negociohet në kuadër të temave për fazën vijuese²³.

Ndërsa ka nisur faza finale me synimin e arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjrisht e obligueshme, ka munguar një skenim i marrëveshjeve të deritashme.

Dy janë marrëveshjet kryesore për të cilat pandehen Kosova dhe Serbia, se nuk u kanë shkuar deri në fund zotimeve. Serbia deri më tani ka penguar hapjen e urës mbi lumin Ibër në Mitrovicë, ndërsa Kosova nuk ka përmbushur obligimin për themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së Komunave Serbe, të cilin Serbia e sheh si mekanizëm nën ombrellën e të cilit do ta fusë edhe shëndetësinë. Në mesin e objektivave të listuara në Marrëveshjen e Parimeve për Asociacionin, e nënshkruar në vitin 2015, është edhe "d) ushtrimi e veshtrimit të plotë për përmirësimin e shëndetësisë lokale primare e sekondare dhe përkujdesjes sociale²⁴. Por Gjykata Kushtetuese në interpretimin që i kishte bërë kësaj marrëveshjeje pati gjetur shkelje në të gjitha pikat e marrëveshjes, përfshirë atë për shëndetësinë²⁵.

4.2. Bisedimet lidhur me sektorin e shëndetësisë

Nga 33 marrëveshje sa janë arritur deri më tani në dialogun e lehtësuar nga Brukseli, asnjëra prej tyre nuk flet në mënyrë të detajuar për shëndetësinë. Megjithatë janë disa aspekte të trajtuara në kuadër të dialogut e që kanë të bëjnë me shëndetësinë. Më 27 qershor 2015 është arritur marrëveshja për njohjen reciproke të certifikatave të produkteve medicinale mes Kosovës dhe Serbisë, pas komunikimit që të dy palët ia kanë bërë Bashkimit Evropian me të cilën kanë konfirmuar pranimin e marrëveshjes për këtë çështje.²⁶

Marrëveshja nënkupton që barnat e prodhuara në Serbi të cilat deri tani janë vënë në qarkullim në Kosovë pa iu nënshtruar procedurave të regjistrimit, tash e tutje do t'i nënshtrohen këtij procesi dhe do të plasohen në tregun e Kosovës në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu prodhuesve në Kosovë iu mundësohet plasimi i prodhimeve të tyre në tregun e Serbisë. Si rezultat i pranimit reciprok të Certifikatës së Produktit Farmaceutik (CPP), secili bar/medikamentë për të cilin bëhet aplikacion do të realizohet regjistrimi në vendin tjetër.

Sektori i shëndetësisë është trajtuar në kuadër të shuarjes së strukturave paralele, krahas strukturave në fushën e policisë, drejtësisë e mbrojtjes civile. Kësisoj në vitin 2015, qeveria kishte aprovuar konkluzionet e dakorduara për Shpërbërjen e të ashtuquajturës "Mbrojtja Civile" e cila ka funksionuar në komunat veriore të Kosovës, si dhe ka mbështetur zotimet e përcaktuara me këto konkluzione. (Vendimi nr. 06/39 të datës 22.07.2015, 2015)²⁷ Përmes këtij vendimi, ishin obliguar min-

22 Marrëveshjet e Brukselit në Pritje të Zbatimit. (6 korrik 2017). Zyra e Kryeministrit. Gjetur në: <https://kryeministri-ks.net/documents/raport-mar-reveshjet-e-brukselit-ne-pritje-te-zbatimit-06072017>

23 Ish-ministria e Dialogut, Edita Tahiri, më 29 mars 2014, pati hartuar një dokument për fazën vijuese të dialogut, por i cili nuk kishte marrë formë zyrtare.

24 Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore. Zyra e Kryeministrit. Gjetur në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Asociacioni_perkthimi_shqip_-_final.pdf

25 "Gjykata është e brengosur se kuptimi i termit në anglisht "ushtrimin e veshtrimit të plote" (exercise full overview) është dykuptimësh dhe nuk është konform me termat e përdorur në tekstin e Parimeve në gjuhën shqipe dhe as me ata në tekstin e Parimeve në gjuhën serbe. Gjykata verën se tennë në shqip i përdorur në Parime është "ushtrimin e veshtrimit të plote", i cili në anglisht përkethehet perafersisht si "exercise of full view", e i cili është i ngjashëm me thjeshtë të observosh. Gjykata me tej verën se termi në serbisht i përdorur në Parime është "obavljanje potpunog pregleda", i cili në anglisht përkethehet perafersisht si "conduct a full review", e i cili është i ngjashëm me kryerjen e auditimit. https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ko_130_15_shqip.pdf

26 <https://kryeministri-ks.net/arrihet-marreveshja-per-njohjen-reciproke-te-certifikatave-te-produkteve-medicinale-mes-kosoves-dhe-serbise/>
27 Vendimi nr. 06/39 i datës 22.07.2015, miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.



istritë dhe agjencitë përkatëse që të bëjnë zbatimin e konkluzioneve sipas përgjegjësisë ligjore.

Në zbatim të marrëveshjes për shuarjen e strukturave paralele serbe në veri dhe integrimin e tyre në institucionet publike, 22 pjesëtarë të komunitetit serb kanë lidhur kontrata pune me afat të pacaktuar me Ministrinë e Shëndetësisë (MSh), në janar të vitit 2015. Krahas kontratës, ata patën firmosur edhe 'Deklaratën e paraintegrimit', me të cilën deklarohen se janë të gatshëm të transformohen dhe integrohen në kuadër të institucioneve shëndetësore të Kosovës, duke u pajisur me dokument identifikimi të Republikës së Kosovës dhe duke aplikuar edhe për licencim në MSh.

Po deri më tani ka munguar llogaridhënia prej ish-"ilegalëve". Për më tepër, punonjësit të cilët kanë lidhur kontrata me Ministrinë e Shëndetësisë janë paguar pa dalë fare në punë. Kjo e dhënë është evidentuar edhe në raportet e Zyrës Kombëtare të Auditorit për Ministrinë e Shëndetësisë, për vitet 2018 dhe 2019. (Raporti i auditimit për Ministrinë e Shëndetësisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, 2019)²⁸ Sipas kwtij raporti, ky lëshim ka ndodhur për shkak se mungon kontrolli menaxhues, i cili duhet të kujdeset që të gjithë nëpunësit publikë të jenë të pranishëm në vendin e punës gjatë orarit. Pagesa e këtyre punonjësve, në mungesë të dëshmimeve të vijueshmërisë në punë ka dëmtuar buxhetin e MSh-së për rreth 90 mijë euro.

Pas marrëveshjeve në Bruksel, Ministria e Shëndetësisë ka financuar edhe disa projekte në infrastrukturën shëndetësore në komunat me shumicë serbe, në vlerë prej më shumë se një milionë euro. Projektet kanë pasur të bëjnë me qendra shëndetësore të Kujdesit Parësor Shëndetësor²⁹

Në bazë të ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Mitrovica e Veriut, Graçanica e Shtërpca kanë kompetenca edhe për ofrimin e përkujdesit dytësor shëndetësor, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve të përkujdesit shëndetësor, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e personelit dhe administratorëve të përkujdesit shëndetësor³⁰. Por komuna e Mitrovicës së Veriut, e as komunat tjera në veri- Leposaviç, Zveçan e Zubin Potok, nuk i kanë themeluar drejtoritë komunale të shëndetësisë.

Sipas të ashtuquajturës Zyrë për Kosovë e cila funksionin në kuadër të qeverisë së Serbisë, në letër i kontrollojnë 29 qendra shëndetësore³¹. Pas zgjedhjeve të 14 shkurtit, ku Lista Serbe fitoi në komunat me shumicë serbe, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiçi premtoi spital për Graçanicën dhe Mitrovicën e Veriut. (Koha.net, 2021)

Derisa Serbia planifikon që këto institucione t'i fusë në ombrellën e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, zyrtarë të qeverisë së Kosovës në vazhdimësi kanë deklaruar se nuk do të ketë vendim për krijimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe. Në mesin e pikave të marrëveshjes së nënshkruar në gusht të vitit 2015, është edhe ajo që flet për "ushtrimin e mbikëqyrjes së plotë mbi shëndetësinë lokale primare e sekondare". (Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore)³² Por Gjykata Kushtetuese në interpretimin që i kishte bërë këtij dokumenti pati konstatuar shkelje në të shtatë kapitujt e saj, përfshirë edhe atë që flet për kompetencat në shëndetësinë lokale. (Aktgjykim në Rastin nr. K0130/15, 2015)³³

28 Zyra e Auditorit. (2019). Raporti i auditimit për Ministrinë e Shëndetësisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018. Gjetur në <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2019/05/Raporti-final-i-MSH.pdf>.

29 <https://www.koha.net/arberi/184606/shthurja-e-shendetesise-nuk-u-sherua-nga-dialogu-i-brukselit/>, 18 shtator 2019.

30 Ligji për vetëqeverisjen lokale i miratuar më 2008

31 Shëndetësia paralele në veri të Kosovës. New Perspektiva. (29.09.2017). Gjetur në <https://www.new-perspektiva.com/sq/shendetesia-paralele-ne-veri-te-kosoves/>. Qasur më 23.03.2021

32 Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore. Gjetur në https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Asociacioni_perkthimi_shqip_-_final.pdf.

33 Aktgjykim në Rastin nr. K0130/15. (2015). Gjykata Kushtetuese.

5. PËRFUNDIME

- Strukturat paralele vazhdojnë të ekzistojnë në sektorin e shëndetësisë dhe me financimin që ua bënë atyre, Serbia ushtron kontroll mbi zonat e populluara me shumicë serbe. Mosunifikimi i shëndetësisë vazhdon të jetë sfida për shtetin e Kosovës.
- Ndarjes së thellë mes dy sistemeve nuk i është dhënë zgjidhje as pas 21 vjetësh, ku përpjekjet për rregullimit e këtij sektori kanë qenë të pakta. Ndërkohë, zyrtarë të Beogradit kanë paralajmëruar tranzicion të sistemit shëndetësor në kuadër të projekteve të përbashkëta me Ministrinë e Shëndetësisë së Serbisë.
- Mosintegrimi i komunitetit serb manifestohet edhe në sistemin shëndetësor në përgjithësi, pasi pjesa më e madhe e të dhënave mjekësore për serbët nuk raportohet pranë autoriteteve kosovare.
- Për pasojë, mungon një pasqyrë e saktë e profilit shëndetësor të Kosovës për shkak të kufizimeve në shtrirje dhe saktësi të të dhënave.
- Duhet të aplikohet një qasje gjithëpërfshirëse për shërbimet ekzistuese paralele dhe integrimi i tyre në një sistem të unifikuar të bëhet nëpërmjet zgjidhjeve që garantojnë qëndrueshmëri në këtë sektor.
- Sektori shëndetësor në veri krahas atij arsimor nuk është i përfshirë në buxhetin e nivelit lokal që administrohet nga komunat sipas ligjeve Kosovës, dhe kjo ka bërë që realizimi i buxhetit të komunave të jetë i ulët.
- Ndërhyrjet e Serbisë vazhduan edhe gjatë pandemisë COVID-19 duke tentuar t'i furnizojë institucionet serbe edhe me vaksina, situatën kjo që çoi në ndërhyrje të autoriteteve dhe prodhoi debate të ashpra politike brenda vendit.
- Furnizimi i qendrave shëndetësore me medikamente dhe materiale tjera përcjellëse vazhdon të bëhet nga Serbia, edhe pse në disa raste autoritetet e Kosovës ndaluan futjen e tyre.
- Institucionet e Kosovës deri më tani nuk kanë paraqitur ndonjë strategji apo plan veprimi për hapat që duhet ndërmarrë në shuarjen e shëndetësisë paralele serbe dhe integrimin e saj brenda sistemit të Kosovës.

6. REKOMANDIME

- Institucionet e Kosovës duhet t'i identifikojnë pengesat të cilat kanë pamundësuar integrimin e strukturave paralele të kujdesit shëndetësor në një sistem të unifikuar në Kosovë.
- Për shkak të kompleksitetit të çështjes, nevojitet qasje pragmatike, vullnet politik dhe një strategji gjithëpërfshirëse me të gjitha palët e interesit, në funksion të unifikimit të sistemit të shëndetësisë.
- Shëndetësia paralele duhet të jetë një nga temat e fazës finale të dialogut me Serbinë dhe zgjidhja e propozuar të jetë pjesë e një marrëveshje eventuale gjithëpërfshirëse dhe ligjrisht të obligueshme.
- Serbia planifikon që institucionet shëndetësore t'i fusë nën ombrellën e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, me kompetenca të zgjeruara që shkojnë përtej Pakos së Ahtisarit. Qeveria e Kosovës nuk duhet ta pranojë një gjë të tillë, as krijimin e një mekanizmi pa shuarjen e plotë të strukturave paralele, përfshirë ato në sektorin e shëndetësisë.
- Ministria e Shëndetësisë duhet ta konsiderojë ndërtimin e objekteve dhe ofrimin e shërbimeve multi-etnike të kujdesit shëndetësor, ku do të punësohej staf shqiptar dhe serb.
- Institucionet e Republikës së Kosovës, veçanërisht Ministria e Shëndetësisë duhet të tentojë që kur të funksionalizohet Sistemi Informativ Shëndetësor (SISH), ta shtrijë atë edhe në komunat me shumicë serbe, në mënyrë që të ketë qasje në të dhëna që lidhen me shëndetin e popullsisë dhe institucionet shëndetësore.
- Të synohet që, kur të funksionalizohen sigurimet shëndetësore, shtrirja e tyre të behet edhe në komunat me shumicë serbe, në mënyrë që të largohen nga përdorimi kartelat shëndetësore, autoritet lëshues i të cilave është Qeveria e Serbisë.
- Personelit mjekësor serb t'i ofrohet mundësi për zhvillim profesional brenda Kosovës, si një nga mënyrat për ta shkëputur varësinë e tyre nga Beogradi.

BIBLIOGRAFIA

Aktgjykim në Rastin nr. KO130/15. (2015). Gjykata Kushtetuese.

Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore. Gjetur në https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Asociacioni_perkthimi_shqip_-_final.pdf

Spitali i Graçanicës qe dy dekada në kontejnerë. (2020). Evropa e Lirë: <https://www.evropaelire.org/a/spitali-i-gracanices-ne-kontejnere-/30988585.html>. Qasur më 23.03.2021

Dogana parandalon kontrabandën e barnave në rajonin e Gjilanit. (17.11.2016). Dogana e Kosovës. Gjetur në: <https://dogana.rks-gov.net/dogana-parandalon-kontrabanden-e-barnave-ne-rajonin-e-gjilanit/>. Qasur më 23.03.2021

Dialogu Kosovë-Serbi: Sfidat dhe rruga përpara. (2018). Instituti Demokratik i Kosovës (KDI).

Vuçiqi u premton serbëve në Kosovë miliona euro në projekte e shtesa mujore: Veç ruani shtëpitë. (26.02.2021). Koha.net. Gjetur në: <https://www.koha.net/arberi/260210/vuciqi-takon-politikanet-serbe-nga-kosova-ne-kazermen-e-kurshumlise/>. Qasur më 23.03.2021

Koliko Kosta Kosovo. Gjetur në <http://kolikokostakosovo.info/en/>. Qasur më 23.03.2021

Ligji për shëndetësi i miratuar më 2013

Ligji për vetëqeverisjen lokale i miratuar më 2008

Marreveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve. (2013, 04 19). Gjetur në https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Marreveshja_e_Pare_per_Normalizimin_e_Marredhenieve_19_prill_2013.pdf. Qasur më 23.03.2021

Municipal Profiles. (2018). OSCE Mission in Kosovo.

Shëndetësia paralele në veri të Kosovës. New Perspektiva. (29.09.2017). Gjetur në <https://www.new-perspektiva.com/sq/shendetesia-paralele-ne-veri-te-kosoves/>. Qasur më 23.03.2021

Uebfaqja e Qeverisë së Republikës së Serbisë. (18.05.2020). Gjetur në <http://www.kim.gov.rs/lat/v3829.php>. Qasur më 23.03.2021

Komunikatë për media nga Prokurori i Shtetit: <https://prokuroria-rks.org/psh/lajm/6314>. Qasur më 23.03.2021

Zyra e Auditorit. (2019). Raporti i auditimit për Ministrinë e Shëndetësisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018. Gjetur në <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2019/05/Raporti-final-i-MSH.pdf>

Rezolutë për dialogun midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. (2011). Kuvendi i Kosovës.

Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021. (2016). Ministria e Shëndetësisë

Stanculescu, M. S., & Neculau, G. (2014). The Performance of Public Health-care Systems in South-East Europe. Friedrich Ebert Stiftung.

Vendimi nr. 06/39 të datës 22.07.2015. Qeveria e Kosovës.

Marrëveshjet e Brukselit ne Pritje te Zbatimit. (06.07.2017). Zyra e Kryeministrit. Gjetur në: <https://kryeministri-ks.net/documents/raport-marreveshjet-e-brukselit-ne-pritje-te-zbatimit-06072017/>

